



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.75/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Valon Krasniqi nga Suedia, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i parregullt apeli Anr.75/2019, i datës 20.09.2019, i parashtruar nga Valon Krasniqi nga Suedia, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Valon Krasniqi nga Suedia, në të cilën parashtruesi i apelit kërkon të dijë se pse i njëjti nuk është përfshirë në listat e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019.

Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të pretendimeve në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi rregullsinë e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i parregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Valon Krasniqi është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015, nenit 10.7.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 75/2019 më datë 22.09.2019.

Kryesues i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*